

Hapet thirrja për aplikime për bursa në kuadër të programit Erasmus+ KA107 në Universitetin Aksaray në Turqi, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës për trajnim, për të marrë pjesë në “Javën Ndërkombëtare” që ky universitet do të organizojë në datat 17 - 21 Tetor 2022.

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Aksaray, Turqi, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës për trajnim në datat 17 – 21 Tetor 2022.

<https://www.aksaray.edu.tr/>

Llojet e mobilitetit /kohëzgjatja:

- Shkëmbimin e stafit akademik me kohë të plotë për trajnim (5 ditë + 2 ditët e udhëtimit);

Fushat e shkëmbimit:

- Gjuhë angleze;
- Gjuhë turke;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor për stafin (140 Eur / ditë);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm) | Kompensimi |
|---|------------|
| Midis 100 dhe 499 KM | 180 EUR |
| Midis 500 dhe 1999 KM | 275 EUR |
| Midis 2000 dhe 2999 KM | 360 EUR |
| Midis 3000 dhe 3999 KM | 530 EUR |
| Midis 4000 dhe 7999 KM | 820 EUR |
| 8000 KM ose më shumë | 1100 EUR |

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik me kohë të plotë:

- CV (në gjuhën angleze / turke) + Lista e publikimeve;
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze / turke);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);

- Certifikata e gjuhës së huaj;
- Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo më parë një mobilitet në kuadër të programit Erasmus+ dhe nëse po, ku;
- Plani i mobilitetit për trajnim;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:

https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Training_outgoing-1.docx

Plani i Mobilitetit për trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti në momentin e aplikimit dhe më pas nga Koordinatorin Institucional Erasmus+.

Afati për aplikim: 16 Shtator 2022

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!